

KONKURS**Menaxher i Sektorit të Thesarit (m/f)****Kualifikimet:**

- Kualifikim universitar, preferohet kualifikimi MA;
- Së paku 2 vite përvojë menaxheriale;
- Aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit, negocimit dhe prezantimit;
- Aftësi të shkëlqyeshme analitike dhe inovative;
- Shkathtësi në caktimin e objektivave dhe planifikimin e punës;
- I/e aftë të punojë në ekip dhe në mënyrë të pavarur;
- Nivel i avancuar i Gjuhës Angleze dhe përdorimit të Microsoft Office-it.

Përgjegjësitë:

- Menaxhon likuiditetin e bankës, bën planifikimet e kërkesave për mjete likuide nëpër afate të ndryshme kohore dhe sigurohet që banka ka likuiditet të mjaftueshëm për kryerjen e obligimeve të veta në kohë;
- Menaxhon portofolin e investimeve të bankës nëpër instrumente të ndryshme financiare dhe bën propozime për investime të reja sipas kritereve të lejuara nga Rregullatori dhe politikave të brendshme investive të bankës;
- Përcjellë respektimin e limiteve, ekspozimeve, gjendjeve të parasë, neto pozicioneve të hapura dhe merr vendime sipas limiteve të përcaktuara nga Rregullatori dhe atyre të brendshme të bankës;
- Përpilon udhëzime, instruksione, memo, procedura, statute dhe politika të praktikave më të përshtatshme, përmes të cilave do të përshkruhet, menaxhohet, kontrollohet dhe sigurohet mbarëvajtja e të gjitha operacioneve të kryera në Thesar;
- Angazhohet në analizimin e vazhdueshëm të aktiviteteve dhe proceseve të mbuluara nga Thesari dhe analizon vazhdimisht mundësinë e përmirësimit të proceseve dhe optimizimit të tyre;
- Është përgjegjës për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas pozitave në Thesar dhe siguron delegimin e detyrave tek stafi i Thesarit sipas niveleve të përcaktuara;
- Mbështetë degët për çdo lloj problemi që kanë të bëjë me Thesarin dhe përkrahë biznesin në arritjen e objektivave të përgjithshme të bankës;
- Kryen kontrolla dhe vizita të vazhdueshme nëpër degë me qëllim të kontrollimit të parasë së gatshme dhe mbështetjes së degëve;
- Siguron respektimin e parimit në katër sy;
- Është përgjegjës për organizimin e komiteteve përkatëse të Thesarit (ALCO, Komiteti i Investimeve, etj);

- Organizon trajnime për stafin e bankës sipas nevojës sa i përket proceseve që realizohen nga Departamenti i Thesarit;
- Kërkon dhe siguron trajnime sa më relevante për stafin e angazhuar në Thesar, duke tentuar kështu gjithmonë në ngritjen e profesionalizmit të stafit;
- Përfaqëson Bankën në kuadër të Shoqatës së Bankave dhe në takime me përfaqësues nga bankat korrespondente sa i përket fushës së Thesarit;
- Mbanë kontakte të shëndosha dhe përkrahëse me Bankën Qendrore të Kosovës dhe Qeverinë e Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e Thesarit;
- Mbanë kontakte me bankat korrespondente, si dhe zgjeron bashkëpunimin me bankat tjera;
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesave të departamentit dhe mbikëqyrësit direkt.

Procedura e aplikimit:

Plotësoni formularin për aplikim i cili gjendet në këtë link: <https://www.bpbbank.com/forma-e-aplikimit-per-punesim/>

Pas seleksionimit të dokumentacionit do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë.

Afati i aplikimit është deri me datë: **21.06.2019**